



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-181775
Datë 23.12.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b dhe g të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kryetari i Komunës, më 23 dhjetor 2014 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. Formohet dhe emërohet Komisioni për pranim-dorëzimin e çelësave të banesave të parapara në bazë të marrëveshjes me PPP-me Ndërmarrjen “Fat Group”.
- II. Për anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 1. Elhame Berisha, drejtoreshë e DPMS, kryesuese,
 2. Raim Alija, nga Sektori i Pronës,
 3. Dukagjin Berisha, nga DGJK, dhe
 4. Refki Musbegu, nga DUPH.
- III. Komisioni nga pika II e këtij Aktvendimi, do t’i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me marrëveshjen mbi Partneritetin Publiko- Privat (PPP) nr. 01-101/2013 të datës 3.7.2013, të lidhur ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe “Fat Group” Sh.p.k, të pikës I të këtij aktvendimi dhe në pajtim me ligjet në fuqi.
- IV. Autorizohet Komisioni i cekur në pikën II të këtij Aktvendimi, që në emër të Komunës së Prizrenit, të bëjë pranimin e çelësave të këtyre banesave.
- V. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe të emëruarit.
- VI. Udhëzim juridik: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së tij, Komisionit për Ankesa, në KK Prizren.



Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti




Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-181780
Datë 23.12.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b dhe g të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kryetari i Komunës, më 23 dhjetor 2014 mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, bazuar në kërkesën e Arjeta Çaker, e evidentuar si rast social, për lirimin nga pagesa e kontributeve për rregullimin e tokës ndërtimore (taksat për leje ndërtimore) lidhur me ndërtimin e shtëpisë familjare të banimit të saj, kështu që obliguesja e kësaj takse, Arjeta Çaker, lirohet nga taksa e lartcekur, e cila i është caktuar nga shërbimi i kompetent i Komunës.
- II. Lirimi nga pagesa e kontributit për rregullimin e tokës ndërtimore (taksat për leje ndërtimore), e cila është llogarit në shumën prej 494.16 €, konsiderohen si participim (donacion) i Komunës së Prizrenit në ndërtimin e këtij objekti.
- III. Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.
- IV. Me këtë konkluzion të njoftohen Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, e lartcekura, si dhe Arkivi.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-181781
Më 23.12.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, kryetari i Komunës më 23 dhjetor 2014, miratoi këtë:

AKTVENDIM

- I. Formohet dhe emërohet komisioni për pranimin e punëve teknike lidhur me rehabilitimin dhe adaptimin e Web faqes “Prizreni 360”.
Anëtarë të këtij komisioni, emërohen:
 - a. Ymer Berisha, shef i ZI,
 - b. Gëzim Gërgi, nga TI, dhe
 - c. Shkodran Kryeziu, nga DTZHE.
- II. Komisioni nga pika I e këtij Aktvendimi do të zhvilloj të gjitha procedurat ligjore që kanë të bëjnë me pranimin e punëve teknike lidhur me rehabilitimin dhe adaptimin e Web faqes “Prizreni 360” me teknologji me të re.
- III. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi
- IV. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, si dhe të emëruarit.
- V. Me këtë Aktvendim të njoftohen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, të emëruarit, dhe Arkivi.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-181021
Datë 23.12.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 108 të Ligjit për Procedurën Administrative, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për plotësimin dhe ndryshimin e Konkluzionit nr. 01-06-157665 të datës 11.11.2014, kryetari i Komunës, më 23 dhjetor 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për ndryshimin dhe plotësimin e Konkluzionit nr. 01-06-157665 të datës 11.11.2014, që ka të bëjë me lejimin e shpalljes së tenderit për blerjen e një kontejneri për banim për Jovica Korolejiq, pjesëtarë i komunitetit serb, kështu që në vend të fjalës: “lejohe shpallja e tenderit për blerje të një kontejneri” duhet të jetë:
- II. Lejohe blerja e një kontejneri për banim për Jovica Korolejiq, pjesëtarë i komunitetit serb dhe për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën prej 1900 €.
- III. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin II të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve të Zyrës për Komunitete dhe Kthim.
- IV. Për implementimin e këtij projekti formohet komisioni në këtë përbërje:
 - a. Cengiz Curciali, ZKK
 - b. Spasa Andrijeviq, ZKK dhe
 - c. Bashkim Lubovci. DEF.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, komisioni dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja